# MARREVESHJE E TRANSFERIMIT TE AKSIONEVE

Sot, me date 7 Dhjetor 2021, ne Tirane, palet e meposhme kane hyre ne Marreveshjen si me poshte vijon:

**BANKA EUROPIANE PER RINDERTIM DHE ZHVILLIM,** nje organizate nderkombetare e formuar me traktat te dates 29 Maj 1990, e perfaqesuar ne kete marreveshje nga Znj. Anjeza Hobdari, Bankier Principal, e pajisur me prokure te dates 19 Nentor 2021, (referuar si "**BERZH**" ose "**Shitesi**")

dhe

**UNION FINANCIAR TIRANE SH.A**, nje shoqeri e organizuar dhe ekzistuese ne perputhje me ligjet e Shqiperise, me adrese ne Rruga "Ismail Qemali", Nr.32, Kati 3, Kodi Postar 1019, Njësia Bashkiake Nr.5, perfaqesuar ne kete marreveshje nga Drejtori Ekzekutiv Z. Elton Çollaku dhe Drejtore e Departamentit te Finances Znj.Mirela Likaj, (referuar si "**Bleresi**")

## 1. HYRJE

1.1 Me date 17 Prill 2019, Union Financiar Tirane SH.A, ne cilesine e Bleresit, BERZH, ne cilesine e Shitesit, si dhe Aksioneret e Pakices (sic perkufizohen me poshte), ne cilesine e garantuesit, kane hyre ne nje Marreveshje per Shitblerjen e Aksioneve per shitjen e te gjithe aksioneve te Shoqerise nga BERZH tek Bleresi, sipas kushteve dhe afateve te percaktuara ketu (duke pasur parasysh qe kjo blerje do te ndodh ne disa faza/pjese sikunder percaktohet ne Marreveshjen per Shitblerjen e Aksioneve). Me date 29 Maj 2020 Shitesi, Bleresi dhe Aksionaret e Pakices vendosen te nenshkruajne ndryshimin e Marreveshjes per Shitblerjen e Aksioneve duke ndryshuar Tabelen e Daljes te percaktuar ne Seksionin 2.01.(b) dhe duke vendosur keshtu riorganizimin e numrit te pjeseve, periudhave per transferimin e ketyre pjeseve si dhe numrin e aksioneve dhe cmimin per cdo pjese (me tej "**MSA**");

1.2 Pas kompletimit te fazes se pare nepermjet Marreveshjes se Transferimit te Aksioneve date 7 Qershor 2019, te fazes se dyte nepermjet Marreveshjes se Transferimit te Aksioneve date 12 Dhjetor 2019, te fazes se trete nepermjet Marreveshjes se Transferimit te Aksioneve date 7 Dhjetor 2020 dhe te fazes se katert nepermjet Marreveshjes se Transferimit te Aksioneve date 7 Qershor 2021, tani Shitesi eshte pronari legjitim dhe ka titull te plote pronesie mbi 35,358 aksione (tridhjete e pese mije, e treqind e pesedhjete e tete aksione) te Shoqerise, me vlere nominale 1,296.744 Leke secila (afersisht e barabarte me 10 EURO secila), te mbajtura nga Shitesi, me nje vlere nominale totale prej 45,850,274. 352 Leke (dyzet e pese million e teteqind e pesedhjete mije e dyqind e shtatedhjete e kater pike treqind e pesedhjete e dy), te kapitalit teresisht te dilutuar dhe te se drejtes se votes se Shoqerise dhe Bleresi deshiron te bleje Aksionet ne Shitje (sic percaktohet me poshte) nga Shitesi.

1.3 Tani ne baze te Tabeles se Daljes te ndryshuar te MSA, palet do te permbushin transferimin e pjeses se peste te aksioneve, e cila eshte edhe pjesa e fundit dhe finale dhe qe perfaqeson totalin e aksioneve te zoteruara nga Shitesi ne Shoqeri, duke nenshkruar kete marreveshje.

Eshte rene dakort si me poshte vijon:

## 1. PERKUFIZIME/INTERPRETIME

1.1 Fjalet e meposhtme do te kene kuptimin e dhene me poshte, pervecse kur konteksti e kerkon ndryshe:

| | |
|---|---|
| **"Marreveshje"** | nenkupton kete Marreveshje Transferimi. |
| **"Data e Marreveshjes "** | nenkupton daten e nenshkrimit te kesaj Marreveshje |
| **"Shoqeri"** | nenkupton Union Bank SH.A, nje shoqeri aksionere organizuar dhe ekzistuese ne perputhje me ligjet e Shqiperise me nr.NUIS K51807801R dhe adrese ne Njesia Bashkiake Nr.9, Sheshi Ferenc Nopçka, Ndertesa Nr.5, Kodi postar 1016, Tirana, Albania. |
| **"Ligj"** ose **"Ligje"** | nenkupton cdo traktat, direktive, marreveshje nderkombetare, ligj, statut, dekret, rregullore, urdher, kod, rregullim, urdherese, vendim gjykate,udhezim (perfshire interpretim gjyqesor apo administrativ) si dhe cdo autorizim qeveritar. |
| **"Aksioneret e pakices"** | nenkupton Z. EDMOND LEKA, nje shtetas shqiptar me banim ne Rruga Ismail Qemali, Nd. 20, H. 4, Ap. 47, 1019, Tirane, Shqiperi,mbajtes i kartes te identitetit me numer 034021166 dhe Z. NIKO LEKA, nje shtetas shqiptar me banim ne Rruga Perlat Rexhepi, Nd. 1, H.6, Ap. 59, 1019, Tirane, Shqiperi,mbajtes i i kartes te identitetit me numer 033380369. |
| **"Palet"** | nenkupton sebashku Bleresin dhe Shitesin. |
| **"Aksionet ne Shitje"** | nenkupton te gjitha aksionet e zoteruara nga Shitesi ne Shoqeri dhe qe perfaqesojne totalin e kapitalit teresisht te dilutuar si dhe te te drejtave te votes te zoteruara nga Shitesi ne Shoqeri. |
| **"MSA"** | do te kete kuptimin e dhene ne Hyrje pika 1.1. |

### 1.2 Interpretime

a) Titujt e te gjitha dispozitave jane vene ketu per efekt reference dhe nuk do te ndryshojne, modifikojne, zgjerojne apo kufizojne asnje nga dispozitat.

b) Pervec se kur parashikohet ndryshe ne kete Marreveshje, termat e perdorura ne kete Marreveshje do te kene kuptimin e dhene atyre ne MSA.

c) Ne rast konflikti mes dispozitave te kesaj Marreveshje dhe MSA, MSA do te mbizoteroje.

## 2. OBJEKT I MARREVESHJES

2.1 Ne perputhje me kushtet dhe afatet e percaktuara ne kete Marreveshje dhe ne MSA, Shitesi shet dhe transferon Aksionet ne Shitje tek Bleresi dhe njekohesisht Bleresi blen dhe pranon transferimin e Aksioneve ne Shitje nga Shitesi.

## 3. ÇMIMII SHITJES

3.1 Çmimi i Shitjes per Aksionet ne Shitje eshte EURO 591,667 (peseqind e nentedhjete e nje mije e gjashteqind e gjashtedhjete e shtate).

3.2 Çmimi i Shitjes do te paguhet nga Bleresi tek Shitesi ne perputhje me dispozitat e MSA dhe, siç eshte e zbatueshme, do te reduktohet me vleren neto te çdo dividenti te paguar nga Shoqeria dhe te marre nga Shitesi, siç eshte parashikuar, dhe ne perputhje me, Klauzolen 2.01.(e) te MSA.

## 4. TRANSFERIMI I AKSIONEVE NE SHITJE

4.1 Titulli i pronesise se Aksioneve ne Shitje i transferohet Bleresit, menjehere ne daten e nenshkrimit te kesaj Marreveshje.

## 5. DAKORDESIME

5.1 Shitesi do te ndermarre te gjithe ato veprime dhe hapa te tjera sic mund te kerkohet ose te jete e nevojshme per te mundesuar dhe per te kaluar ne menyre te plote, ligjore, te pabarresuar titullin e pronesise mbi Aksionet ne Shitje.

5.2 Aksionet ne Shitje do te transferohen tek Bleresi sebashku me te drejtat e lidhura me to.

## 6. SHPENZIMET

6.1 Shpenzimet e bera ne lidhje me negocimin, nenshkrimin dhe ekzekutimin e dokumentacionit ligjerisht te detyrueshem per transferimin e Aksioneve ne Shitje do te paguhen ne perputhje me MSA.

6.2 Te gjitha vulat dhe taksat e regjistrimit, detyrimet doganore, tarifat dhe cdo tarife noteriale, nese ka, qe mund te lindin si rezultat i nenshkrimit te kesaj Marreveshjeje dhe transferimi i Aksioneve ne Shitje, do te perballohen nga Bleresi.

## 7. LIGJI I ZBATUESHEM

7.1 Kjo Marreveshje dhe marredhenia midis Paleve do te rregullohen dhe interpretohen ne perputhje me ligjin shqiptar.

## 8. TE TJERA

8.1 Asnje ndryshim, modifikim, ndryshim ose variacion i kesaj Marreveshjeje nuk do te jete i vlefshem nese nuk eshte me shkrim dhe nenshkruar nga secila Pale.

8.2 Nese ne cdo kohe ndonje dispozite e kesaj Marreveshjeje eshte ose behet e

paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme, atehere kjo dispozite do te konsiderohet e ndare nga kjo Marreveshje dhe nese eshte e mundur zevendesohet me nje dispozite te ligjshme qe kryen qellimin e kerkuar te Paleve sipas kesaj Marreveshjeje dhe kjo nuk do te ndikoje ose te pengoje vlefshmerine apo zbatueshmerine e ndonje dispozite tjeter te kesaj Marreveshjeje.

8.3 MSA, edhe pse jo fizikisht bashkangjitur kesaj Marreveshjeje, eshte pjese perberese e saj. Per shmangien e dyshimit, Palet shprehimisht bien dakort qe dispozitat sipas Seksionit 4.12 (*Privilegjet dhe Imunitetet e Shitesit*) te MSA do te zbatohen per kete Marreveshje.

## 9. GJUHA DHE NUMRI I KOPJEVE

9.1 Kjo Marreveshje nenshkruhet ne gjuhen Angleze dhe perkthehet ne Shqip. Versioni ne gjuhen Angleze do te jete gjuha mbizoteruese ne rast te konfliktit ndermjet dy versioneve.

Palet nenshkruajne kete Marreveshje ne kater (4) kopje ne gjuhen shqipe dhe kater (4) kopje ne gjuhen angleze ne vendin dhe ne daten e percaktuar ne faqen 1 te kesaj Marreveshjeje.

**UNION FINANCIAR TIRANE SH.A**

UNION FINANCIAR TIRANE sh.a.
Rruga "Ismail Qemali" Nr.32
Kodi Postar 1019, Njesia Bashkiake N. 5
NIPT : J62424002G

Nga: ______________________
Emri: Elton Collaku
Pozicioni: Drejtori Ekzekutiv

Nga: ______________________
Emri: Mirela Likaj
Pozicioni: Drejtori Financiar

**BANKA EUROPIANE PER RINDERTIM DHE ZHVILLIM**

Nga: ______________________
Emri: Anjeza Hobdari

Pozicioni: Bankier Principal

**European Bank**
for Reconstruction and Development

Union Financiar Tirane SH.A.
Tirana, Albania

Attn: Mr Elton Collaku, CEO

29 May 2020

Dear Sir,

**Subject: Union Bank Tirana- Operation No.35890**

1. Please refer to the Share Purchase and Sale Agreement dated 17 April 2019 (the "Share Purchase and Sale Agreement"), between Union Financier Tirana Sh.A (the "Purchaser"), Mr Edmond Leka and Mr Niko Leka ( Mr Edmond Leka and Niko Leka collectively, the "Guarantors") and the European Bank for Reconstruction and Development (the "Vendor" or the "Bank").

2. Expressions defined in the Share Purchase and Sale Agreement bear the same meanings herein.

3. Subject to paragraph 4 of this letter agreement, it is hereby agreed that, effective from the Effective Date (as defined below), the Exit Schedule from Section 2.01(b) of Share Purchase and Sale is hereby deleted in its entirety and replaced with the following:

| Tranche Completion Date | Tranche Purchase Price | | EBRD Shares Transferred |
|---|---|---|---|
| 07-Jun-19 | 591,667 | less any Applicable Dividends | 35,357 |
| 07-Dec-19 | 591,667 | less any Applicable Dividends | 35,357 |
| 07-Jun-20 | 0 | | 0 |
| 07-Dec-20 | **887,501** | less any Applicable Dividends | **53,035** |
| 07-Jun-21 | **887,501** | less any Applicable Dividends | **53,036** |
| 07-Dec-21 | 591,667 | less any Applicable Dividends | 35,357 |

4. This letter agreement shall constitute an amendment to the Share Purchase and Sale Agreement, and, except for the amendments provided for in paragraph 3 above, the Share Purchase and Sale Agreement shall continue in full force and effect; provided that this letter agreement and the amendments contained herein shall take effect from

European Bank
for Reconstruction and Development

the date upon which it has been accepted by the Purchaser and the Guarantors in the form requested in paragraph 8 below (the "Effective Date") and based on the condition that an upfront amendment fee EUR 12,384 will be paid on or before 7 June 2020.

5. The contents of this letter agreement shall not impair any right, power or remedy of the Bank with respect to any other terms of the Share Purchase and Sale Agreement or be construed as a waiver thereof or an acquiescence therein.

6. This letter agreement shall be governed and construed in accordance with English law.

7. The provisions of Sections 4.5 (*Notices*), 4.11 (*Arbitration and Jurisdiction*), 4.12 (*Privileges and Immunities of EBRD*), 4.13 (*Successors and Assigns*), 4.14 (*Right of Third Parties*) and 4.17 (*Counterparts*) of the Share Purchase and Sale Agreement are hereby incorporated by reference into this letter agreement with the intent that such provisions be applicable to this letter agreement and the rights and obligations of the parties hereto, as if set forth herein in full, *mutatis mutandis*.

8. Please confirm your agreement with the terms of this letter agreement by dating and countersigning the enclosed duplicate of this letter agreement in the space provided below and returning it to us.

Yours sincerely,

**EUROPEAN BANK**
**FOR RECONSTRUCTION AND DEVELOPMENT**

Busola Akanji
Principal Portfolio Manager
Operation Administration Department

**Acknowledged and agreed by the Purchaser**

Name: Eldon Collaku
Title: CEO

Date: 01/06/2020

UNION FINANCIAR TIRANE sh.a.
Rruga "Ismail Qemali" Nr.32
Kodi Postar 1019, Njesia Bashkiake N 5

**European Bank**
**for Reconstruction and Development**

**Acknowledged and agreed by Mr Edmond Leka:**

Edmond Leka ..........................................

Name:
Title:

Date: 20. May. 2010

**Acknowledged and agreed by Mr Niko Leka:**

Niko Leka ..........................................

Name:
Title:

Date: ........................

**Banka Europiane**

**per Rindertim dhe Zhvillim**

Union Financiar Tirane SH.A.

Tirane, Shqiperi

Ne vemendje te: Z. Elton Collaku. CEO

29 Maj 2020

I nderuar zoteri,

**Lenda: Union Bank Tirane - Veprimi Nr.35890**

1. Ju lutem referojuni Marreveshjes se Blerjes dhe Shitjes se Aksioneve te dates 17 Prill 2019 ("Marreveshja e Blerjes dhe Shitjes se Aksioneve"), midis Union Financiar Tirane Sh.A ("Bleresi"), Z. Edmond Leka dhe Z. Niko Leka (Z. Edmond Leka dhe Niko Leka se bashku, "Garantuesit") dhe Banka Evropiane per Rindertim dhe Zhvillim ("Shitesi" ose "Banka").

2. Shprehjet e percaktuara ne Marreveshjen e Blerjes dhe Shitjes se Aksioneve kane te njejtat kuptime si ketu.

3. Sipas paragrafit 4 te kesaj Letre Marreveshjeje, eshte rene dakord neperjet kesaj qe, duke filluar nga Data e Hyrjes ne Fuqi (sic percaktohet me poshte), Tabela e Daljes nga Seksioni 2.01 (b) e Blerjes dhe Shitjes se Aksioneve fshihet ne teresine e saj dhe zevendesohet me sa me poshte:

| **Data e Kompletimit te Pjeseve** | **Cmimi i Blerjes se Pjeseve** | | **BERZH Aksionet e Transferuara** |
|---|---|---|---|
| 07-Qer-19 | 591,667 | me pak Dividente te Zbatueshem | 35,357 |
| 07-Dhje-19 | 591.667 | me pak Dividente te Zbatueshem | 35.357 |
| 07-Qer-20 | 0 | | 0 |
| 07-Dhje-20 | **887,501** | me pak Dividente te Zbatueshem | **53,035** |
| 07-Qer-21 | **887,501** | me pak Dividente te Zbatueshem | **53,036** |
| 07-Dhje-21 | 591.667 | me pak Dividente te Zbatueshem | 35,357 |

4. Kjo leter marreveshje do te perbeje nje ndryshim ne Marreveshjen e Blerjes dhe Shitjes se Aksioneve dhe, pervec ndryshimeve te parashikuara ne paragrafin 3 me siper, Marreveshja e Blerjes dhe Shitjes se Aksioneve do te vazhdoje ne fuqi dhe efekt te plote: me kusht qe kjo leter marreveshje dhe ndryshimet te perfshira ketu do te hyjne ne fuqi nga data ne te cilen eshte pranuar nga Bleresi dhe Garantuesit ne formen e kerkuar ne paragrafin 8 me

poshte ("Data e Hyrjes ne Fuqi") dhe bazuar ne kushtin qe nje tarife e ndryshimit paraprak prej 12,384 EUR te paguhet me ose para 7 Qershorit 2020.

**Banka Europiane**
**per Rindertim dhe Zhvillim**

5. Permbajtja e kesaj leter marreveshjeje nuk do te demtoje asnje te drejte, kompetence ose korrigjim te Bankes ne lidhje me ndonje kusht tjeter te Marreveshjes se Blerjes dhe Shitjes se Aksioneve, ose te interpretohet si heqje dore prej saj ose si nje pranim ne heshtje.

6. Kjo leter marreveshje do te udhehiqet dhe hartohet ne perputhje me ligjin Anglez.

7. Dispozitat e Seksioneve 4.5 (*Njoftimet*), 4.11 (*Arbitrazhi dhe Juridiksioni*). 4.12 (*Privilegjet dhe Imunitetet e BERZH*), 4.13 (*Pasardhesit dhe Transferimet*) A. \ 4 (*E Drejta e Paleve te Treta*) dhe 4.17 (*Homologet*) e Marreveshjes se Blerjes dhe Shitjes se Aksioneve perfshihen duke iu referuar kesaj leter marreveshje me qellimin qe dispozitat e tilla te jene te zbatueshme per kete leter marreveshje dhe te drejtat dhe detyrimet e paleve ketu, sikur te jene te percaktuara ketu plotesisht, perfshire ndryshimet e herepashereshme

8. Ju lutemi konfirmoni dakordesine tuaj me kushtet e kesaj leter marreveshje duke vendosur daten dhe kundernenshkruar kopjen e bashkelidhur te kesaj leter marreveshje ne hapesiren e caktuar me poshte dhe duke e kthyer ate te ne.

Sinqerisht,

**BANKA EUROPIANE**
**PER RINDERTIM DHE ZHVILLIM**

(nenshkrimi)

____________

Busola Akanji
Menaxheri Kryesor i Portofolit
Departamenti i Administrimit te Veprimeve

**Pranuar dhe rene dakord nga Bleresi**

................................ (nenshkrimi)

Emri:

Titulli: CEO

Date: 01/06/2020

(vula)

**Pranuar dhe rene dakord nga Z. Edmond Leka**

................................ (nenshkrimi)

Emri:

Titulli: Date: 30 Maj 2020

**Banka Europiane**

**Per Rindertim dhe Zhvillim**

**Pranuar dhe rene dakord nga Z. Niko Leka:**

.......................... (nenshkrimi)

Emri:

Titulli: Date: ..................

Perktheu : Xhulberta Selamaj

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**
**DEGA VENDORE TIRANË**
**NOTER VALBONA SH. SELIMI**

V20210527303286141177

| |
|---|
| **DATE 28/06/2021** |
| **NR REP 4479** |

## VËRTETIM PËRKTHIMI

Sot, para meje Notere VALBONA SH. SELIMI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, ne zyren time në adresën NR.3, HOXHA TASIM, NR.292, u paraqit personalisht:

**PËRKTHYESE**: Xhilberta Selamaj, e njohur personalisht prej meje, me Leternjoftim ID nr. 037008042 e cila më deklaroi se përktheu me përpikmëri dhe saktësi dokumentin bashkangjitur ne gjuhen shqipe dhe e nënshkroi rregullisht përpara meje Noteres.

Në referim të nenit 135, i ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë";" në Republikën e Shqipërisë unë Noterja vërtetohet nënshkrimi i përkthyeses.

**NOTER**

VALBONA SH. SELIMI

PULLE TARIFE 200 LEKE R.SHQIPERISE